Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues _____	*Data e autorizimit të ekspertit:* **22.04.2022**	*Data e dorëzimit të raportit:* **26.04.2022**	*Nr. i lëndës:* **68/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **22.03.2022**, OE: **"Interlabi" Shpk –Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **68/22**, kundër **Njoftimit për kontratës,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-paliativ i të smuarëve në Komunën e Vitisë",** me nr. të prokurimit: **657-22-658-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Kuvendi i Komunal Viti.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Kontratë Publike Kornizë - Shërbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **700,000.00 €**

Shënim: Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Interlabi" Sh.p.k. – Prishtinë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së:

- **Neni 7** Barazia ne trajtim jo diskriminim
- **Neni 27** Dosja e tenderit
- **Neni 69** Paragrafi 4 Pika (ii) Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Ankuesi paraqet kërkese për rishqyrtim kundër dokumenteve te tenderit dhe njoftimit për kontrate ne pajtim me nenin 108/A paragrafi 3 "*Kërkesa për rishqyrtim duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me poste ose me çdo mjet tjetre te komunikimit te lejuar me këtë ligje, brenda afateve te mëposhtme*" Pika 1 "**ne qofte se shkelja e supozuar kat e beje me njoftimin për kontrate ose me dokumentet e tenderit brenda pese (5) ditëve para afatit te fundit për dorëzimin e ofertave".**

Faza e Informatave shtese – Pyetje sqaruese

Pretendimet tona ankimore tanishme paraprakisht janë paraqitur edhe ne fazën e informata shtese, respektivisht me datën: 02.03.2022, ku kemi pranuar një përgjigje qe është një formulim i përgjithshëm i paqarte dhe i mangët ne raport me pyetjen tonet e parashtruar. Për me shume shih përgjigjen nga AK-ja:

Ju përgjigjemi ne pyetjen e juaj lidhur me projektin Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-paliativ i te sëmurëve ne Komunën e Vitisë VI657-22-006-211

Brenda pyetjes suaj është edhe përgjigje, andaj nuk kemi çka te themi me shume se sa

Ju qe keni ofruar ne pyetjen tuaj

Sa i përket **"ngjashëm"** dhe **"njëjte"** është me te njëjtin kuptim

Koment: Ne baze te kësaj përgjigje ne nuk e kemi te qarte se dështmitë e ofruara nga ATK-ja "Listën e kuponëve fiskal te lëshuar nga ATK-ja" qe kemi kryer shërbime shëndetësore a plotësojnë kërkesën dhe dështminë e dosjes se tenderit, por AK-ja nuk ka kthyer përgjigje për pyetjen tone por vetëm një interpretim se **"ngjashëm"** dhe **"njëjta"** kane te njëjtin kuptim. Bazuar ne praktikat e prokurimit ne Kosove ngjashëm dhe njëjta nuk e kanë kuptimin e njëjte siç është e cekur ne përgjigjen, sepse vet emërtimi i shkruar nuk është i njëjte apo identike mund te ofrohen dështmitë nga OE qe plotësojnë kërkesën dhe dështminë e cekur ne DT.

Dështmi:

- **Kërkesa për informata shtese datës 02.03.2022 përmes e-prokurimit.**
- **Përgjigja AK-se datës 04.03.2022 përmes e-prokurimit.**

Pretendimet ankimore ne kërkesën për rishqyrtim

Te kapaciteti teknik dhe profesional ne FDT është si vijon:

Kërkesë: OE të ofroj Dështmi për projekte të realizuara në tri vitet e fundit nga data e Njoftimit për kontrate , **për shërbime të ngjashme**, minimum ose me shume se Vlera e Planifikimit te projektit

Dështmi: Lista e projekteve për shërbime të realizuara në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate, minimumi sa Vlera e planifikimit te **prezantoj referenca te shërbimeve në lëmine së njëjtë**

Ju lutem shikoni nenin 69 te LPP-se paragrafi 4 pika 2(i &ii) qe rregullon çështjen e shërbime te rëndësishme me numër 2 te prokurimit:

Paragrafi 4, citat: "*Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dështmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:"*

: listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dështmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dështmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Duke ju referuar natyrës se prokurimit **"SHERBIME" – Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-paliativ i te sëmurëve ne Komunën e Vitisë"** me numër prokurimi **(2),** shihet se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vitisë me rastin e përpilimit te dosjes se tenderit nuk mund te vendosin kërkesa dhe dështmie specifiket siç e ka vendosur ne kundërshtim me Paragrafin 4 pika 2.

Kërkesa: për shërbime te ngjashme

Dështmi: te prezantoj referenca te shërbimeve te lëmesë se njehtë.

Operatori ekonomik Interlab SH.P.K., ne cilësinë e blerësit privat sipas paragrafit 4 pika 2 (ii) ofron për qytetaret e Kosovës shërbime shëndetësore te ndryshme si dështmi shih, kuponi fiskal-analiza covid:

Referuar kërkese **“<u>për shërbime te ngjashme</u>”** ne mund te plotësojmë ideshmin e kërkuar dhe si dëshmi te prezantojmë “Listën e kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja” te cilët i kemi lëshuar para datës se publikimit te njoftimit për kontrate për personat privat/qytetaret.

Kërkesa për dorëzim te Listës se kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja ne mënyrë zyrtare besojmë qe përveç qe është ne pajtim me kërkesën e specifikuar ne dosje te tenderit te kërkesa, është ne pajtim me nenin 69 LPP-se, Paragrafi 4 pika 2 (ii) **kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë**.

Ju lutem na konfirmoni zyrtarisht se lista e kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetaret e Kosovës a i plotëson si natyre prokurimit “Shërbime Shëndetësore” nga ofrues privat sipas nenit 69 LPP-se, Paragrafi 4 pika 2 (i & ii)

Për sqarimi tuaj te kërkesa dhe dëshminë nuk janë ne përputhje njëra me tjetrën sepse ne kërkese cekni “**<u>për shërbime te ngjashme</u>**” ndërsa ne dëshminë e kërkoni vetëm “**<u>te prezantoni referenca te shërbimeve ne lëmine se njëjte</u>**”.

Ju lutem po ashtu e modifikoni kërkesën dhe dëshminë e kërkuar ne pajtim me Nenin 69 Paragrafi 4 pika 2 (i & ii) te LPP-se dhe te mundësohet edhe ne si ofertues i shërbimeve shëndetësore – private te plotësojmë kërkesat e dosjes se tenderit e cila duhet te jete ne harmoni me LPP-ne/trajtimi i barabarte.

Te bashkangjitur keni dëshmitë.

PROPOZIM

TE APROVOHET – ANKESA si e bazuar.
TE MODIFIKOHET – Dosja e tenderit (***Ngjashëm dhe njëjta***) dhe te mundësohet trajtimi i barabartë i ankuesit **“Interlab” Sh.p.k.**, si ofertues privat qe te aplikoj për këtë procedure te prokurimit.
KONFIRMONI – Zyrtarisht se “**Lista e kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja**” për **Interlab Shpk**, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetaret e Kosovës, se a plotëson kërkesën dhe ideshmin ne DT si ofertues privat i këtyre shërbimeve sipas Nenit 69 LPP-se, Paragrafi 4 Pika 2 (i & ii), ne mënyrë qe te ofertojmë.
Interlab Sh.p.k., pret përgjigje nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit/njësia e kërkesës ne afat 3 ditësh ne pajtim me Nenin 6 paragrafi 3 te rregullores për paraqitje te kërkese për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktues, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues,
Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë të njëjta me atë te dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	**Evidencat:**
1. OE të ofroj Dëshmi për projekte të realizuara në tri vitet e fundit nga data e Njoftimit për kontrate , për shërbime të ngjashme, minimum ose me shume se Vlera e Planifikimit te projektit	**1. Lista e projekteve për shërbime të realizuara në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate, minimumi sa Vlera e planifikimit te prezantoj referenca te shërbimeve në lëmine së njëjtë**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ankues: "Interlab" Sh.p.k., - Prishtinë, ka parashtruar ankese kundër ***Njoftimit për Kontratë***, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, prandaj nuk ka raport te vlerësimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet të cilat gjenden në platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitur nga operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Interlabi" Sh.p.k. – Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se kërkesa për rishqyrtim kundër dokumenteve te tenderit dhe njoftimit për kontrate ne pajtim me **nenin 108/A paragrafi 3** "*Kërkesa për rishqyrtim duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me poste ose me çdo mjet tjetre te komunikimit te lejuar me këtë ligje, brenda afateve te mëposhtme*" Pika 1 "**ne qofte se shkelja e supozuar kat e beje me njoftimin për kontrate ose me dokumentet e tenderit brenda pese (5) ditëve para afatit te fundit për dorëzimin e ofertave".**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE ankues ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim ma datën 17.03.2022 përmes platformës elektronike, qe i bie 5 dite para hapjes se ofertave pasi qe AK ne **nenin 26.1 te FDT-se** ka përcaktuar hapjen e tenderëve me date 22.03.2022 ne ora 13:00, (22 dite - 17 dite = 5 dite) prandaj OE ankues ka parashtruar kërkese për rishqyrtim 5 dite para hajes se ofertave ne pajtim me **piken 3.1 te par. 3 te nenit 108/A te LPP-se**, si dhe piken a) te **nenit 4 te** "*Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pran Autoriteteve Kontraktues, parashtrim te ankesave pran OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se pretendimet tona ankimore tanishme paraprakisht janë paraqitur edhe ne fazën e informata shtese, respektivisht me datën: 02.03.2022, ku kemi pranuar një përgjigje qe është një formulim i përgjithshëm i paqarte dhe i mangët ne raport me pyetjen tonet e parashtruar. Për me shumë shih përgjigjen nga AK-ja:

Ju përgjigjemi ne pyetjen e juaj lidhur me projektin Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-paliativ i te sëmurëve ne Komunën e Vitisë VI657-22-006-211
Brenda pyetjes suaj është edhe përgjigje, andaj nuk kemi çka te themi me shume se sa
Ju qe keni ofruar ne pyetjen tuaj
Sa i përket **"ngjashëm"** dhe **"njëjte"** është me te njëjtin kuptim

Koment: Ne baze te kësaj përgjigje ne nuk e kemi te qarte se dëshmitë e ofruara nga ATK-ja "Listën e kuponëve fiskal te lëshuar nga ATK-ja" qe kemi kryer shërbime shëndetësore a plotësojnë kërkesën dhe dëshminë e dosjes se tenderit, por AK-ja nuk ka kthyer përgjigje për pyetjen tone por vetëm një interpretim se **"ngjashëm"** dhe **"njëjta"** kane te njëjtin kuptim. Bazuar ne praktikat e prokurimit ne Kosove ngjashëm dhe njëjta nuk e kanë kuptimin e njëjte siç është e cekur ne përgjigjen, sepse vet emërtimi i shkruar nuk është i njëjte apo identike mund te ofrohen dëshmitë nga OE qe plotësojnë kërkesën dhe dëshminë e cekur ne DT.

Dëshmi:

- **Kërkesa për informata shtese datës 02.03.2022 përmes e-prokurimit.**
- **Përgjigja AK-se datës 04.03.2022 përmes e-prokurimit.**

Pretendimet ankimore ne kërkesën për rishqyrtim
Te kapaciteti teknik dhe profesional ne FDT është si vijon:
Kërkesë: OE të ofroj Dëshmi për projekte të realizuara në tri vitet e fundit nga data e Njoftimit për kontrate , **për shërbime të ngjashme**, minimum ose me shume se Vlera e Planifikimit te projektit

Dëshmi: Lista e projekteve për shërbime të realizuara në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate, minimumi sa Vlera e planifikimit te **prezantoj referenca te shërbimeve në lëmine së njëjtë**

Ju lutem shikoni nenin 69 te LPP-se paragrafi 4 pika 2(i &ii) qe rregullon çështjen e shërbime te rëndësishëm me numër 2 te prokurimit:
Paragrafi 4, citat: "*Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:"*
: listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Referuar kërkese **"për shërbime te ngjashme"** ne mund te plotësojmë dëshminë e kërkuar dhe si dëshmi te prezantojmë "Listën e kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja" te cilët i kemi lëshuar para datës se publikimit te njoftimit për kontrate për personat privat/qytetaret.
Kërkesa për dorëzim te Listës se kuporeve fiskal te lëshuar nga ATK-ja ne mënyrë zyrtare besojmë qe përveç qe është ne pajtim me kërkesën e specifikuar ne dosje te tenderit te kërkesa, është ne pajtim me nenin 69 LPP-se, Paragrafi 4 pika 2 (ii) **kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë**.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues – Zyrtari Përgjegjës i prokurimit – Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit.
Do fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Rrjedhimisht përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kritereve te përzgjedhjes dhe kritereve te dhënies, bie apo është përgjegjësi e plote mbi autoritetin kontraktues. ZPP - Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se Tenderit. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te Tenderit, kritereve te përzgjedhjes, si dhe kritereve te dhënies, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoritetit kontraktues.

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues sqaron**, autoriteti kontraktues, duhet te dije me se miri, sepse ata janë te obliguar ti njohin dhe ti përmbushin nevojat për autoritetin kontraktues, ne pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, **Z**yrtari i **P**rokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit ose me fjale tjera ai/ajo është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te tenderit, **kritereve te përzgjedhjes**, si dhe **kritereve te dhënies**, sipas **neni 18 i RrUOPP-se.**
Duke marr për baze kërkesën për sqarime shtese nga OE ankues sipas **nenit 53 te LPP-se** te datës 02.03.2022, ku ka ka kërkuar sqarimi tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, si ne vijim: **Kërkesa 1.** *OE të ofroj Dëshmi për projekte të realizuara në tri vitet e fundit nga data e Njoftimit për kontrate , për shërbime të ngjashme, minimum ose me shume se Vlera e Planifikimit te projektit***, Dëshmia 1.** *Lista e projekteve për shërbime të realizuara në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrate, minimumi sa Vlera e planifikimit te prezantoj referenca te shërbimeve në lëmine së njëjtë*, si dhe përgjigjen nga AK – ZPP te datës 04.03.2022, ku jap një sqarime si ne vijim:

Ju përgjigjemi ne pyetjen e juaj lidhur me projektin Shërbimet e kujdesit Social dhe shëndetësor shtëpiak-paliativ i te sëmurëve ne Komunën e Vitisë VI657-22-006-211
Brenda pyetjes suaj është edhe përgjigje, andaj nuk kemi çka te themi me shume se sa
Ju qe keni ofruar ne pyetjen tuaj
*Sa i përket **"ngjashëm"** dhe **"njëjte"** është me te njëjtin kuptim*

Bazuar ne këto fakte/dëshmi nga sqarimet e kërkuar si me lart nga OE ankues si dhe përgjigjet e ofruara nga AK – ZPP te datës 04.03.2022, arsyetimi ne vendimin me nr. prot. 02-035/02-309 te datës 21.03.2022 mbi kërkesën për rishqyrtim nga ZPP, **eksperti shqyrtues sqaron**, se dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë, ne mënyrë që të mos ketë dykuptimësi te fjalëve ne FDT, kërkesa/dëshmi, por te jene koncizë, te sakta, kuptimplote duke përdorin fjalë te thjeshta, kuptimplotë, të drejta, ne mënyre qe OE qe shfaqin interesim për te marr pjese ne procedura tenderit, te mos kenë nevoje për sqarime shtese dhe kuptimin e fjalëve te përdorura ne dosjen e tenderit nga hartuesit e saj, për përgatitjen e tenderëve te tyre te përgjegjshëm, sipas kritereve te përzgjedhjes dhe kritereve te dhënies. Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit te prezantuar, pretendimet e palës në ankese në këtë pikë **janë pjesërisht të qëndrueshme.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE, **të aprovohet si pjesërisht të bazuar**, dhe rekomandon që autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik dhe të zgjasë afatin kohor për pranimin e tenderëve në përputhje me **par. 7 të nenit 53 të LPP-së**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Viti*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Interlab" Sh.p.k.. – Prishtinë,*